



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:231054  
Datë: 23.02.2024  
Numri i dokumentit: 05366381

**C – IV. – 15 – 1260**

**Paditësi :**

I S nga Prishtina.

**Kundër**

**E paditura :**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lagjja, ”Lakrishtë” Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.23.02.2024**, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. PRANOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit, I S nga Prishtina e parashtruar kundër vendimit PRN173-0281 dt.25.06.2015, të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET**, Vendimi, PRN173-0281 i dt.25.06.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), “NewCo Grand Hotel Shpk” me seli në Prishtinë (në likuidim), ashtu që **OBLIGOHET**, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit, që paditësit, I S nga Prishtina, në emër të 8 (tetë) pagave të papaguara t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **2,345.09 € (dy mijë e tre qind e dy zetë e pesë euro e nëntë cent)**, si dhe kamatën ligjore në shumën prej **234.50 € (dy qind e tri dhjetë e katër euro e pesë dhjetë centë)** dhe se shuma e miratuar, përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat Procedurale dhe Faktike :**

Paditësi, me dt.03.07.2015, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), e përmes dërgimit me postë, ka paraqitur kërkesë për rishikim të Vendimit, PRN173-0281 të dt.25.06.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për shkak të refuzimit të kërkesës për kompensimin të tetë

pagave të pa paguara për periudhën dhjetor 2011 – korrik 2012 në shumë të përgjithshme prej 2,345.09 €, nga Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel Shpk” në likuidim.

Paditësi parashtresën e drejtuar pranë DHPGJSK-së, e kanë titulluar si “*kërkesë*” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në këtë kërkesë, ka theksuar se arsye për hudhjen e kërkesës Agjencia ka cekur nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar të aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut, për të cilën paditësi konsideron se arsyet e parashkrimit nuk ekzistojnë, sepse punëtorët e “NewCo Grand Hotel Shpk” në Prishtinë me dt.20.02.2012, i janë drejtuar agjencisë për këto kërkesa pa marrë përgjigje, andaj me anë të sindikatës përsëri ju kemi drejtuar agjencisë me dt.24.04.2012, por pa përgjigje. Më tej shton se AKP me shkresën nr. 246 dt.07.08.2012 ka njoftuar punëtorët përmes sindikatës se kërkesat për paga të papaguara do shqyrtohen me rastin e fillimit të procedurës së likuidimit, me të cilat shkresa vërtetohet se me kohë i jemi drejtuar AKP-së për kompensimin e pagave të papaguara, andaj i propozon gjykatës që të ri shikoj vendimin e kundërshtuar dhe t’i njihet e drejta në kompenzimin e 8 pagave të pa paguara të cekura dhe kamatën ligjore.

Paditësi kësaj ankese ia ka bashkangjitur provat kopje: Vendimin, PRN173-0281 të dt.25.06.2015 të AL, shkresën dt. 24.04.2012 të Shoqatës Sindikale të GH Prishtina, shkresën dt.26.03.2012 Shoqatës Sindikale të GH Prishtina, vendimin dt. 02.04.2012 të Shoqatës Sindikale të GH Prishtina, Përgjigjen në shkresën e dt.24.07.2012, lëshuar nga AKP nr.246 dt. 07.08.2012, aktvendimin nr.87 dt. 16.03.2012, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kërkesën e punëtorëve dt.04.10.2014, shkresën e punëtorëve dt.23.03.2015, kontratën e punës 01.12.2010, aneks kontrata dt.01.07.2014, kontratë pune dt.02.04.2007, njoftimin për ndërprerje dt.02.02.2015, kontratën e punës 03.01.2007, librezën e punës, lista e punëtorëve me shumatat e pretenduar të përgjithshme, Listat mujore të pagave të pretenduar muaji dhjetor 2011 – muaji korrik 2012 dhe letërnjoftimi.

Me dt.03.04.2023, e paditura, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PRN173-0281 të dt.25.06.2015, e në të cilën ka theksuar se i përmbahet qëndrimit se autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, duke pretenduar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria i vendimit të AL, dhe se ankesat duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me nenin 74.2 të Ligjit Nr.04/L – 034 për AKP-në, se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuar dhe të parashkruara nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se “*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”, dhe nga nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, parashikon që “pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet” andaj bazuar në dispozitat e mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja kur pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, dhe i paraqet gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes si provë i ka bashkangjitur: Vendimin e AL-së, PRN173-0281 të dt.25.06.2015 dhe vendimin e dt.1.11.2022 së AKP-së për emërimin e anëtarëve të AL-së për likuidimin e Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), “NewCo Grand Hotel Shpk” me seli në Prishtinë.

Me Urdhrin e kësaj gjykate dt.05.06.2023, paditësit, i është dërguar mbrojtja (përgjigja) e të paditurës, për të cilën paditësi me parashtrësën dt. 13.06.2013, ka kundërshtuar mbrojtjen e të paditurit, me kërkesë që të aprovet padia e tij si e bazuar.

Me dt.26.06.2023, e paditura, ka paraqitur Kundërpërgjigje në Përgjigjen e paditësit e në të cilën ka theksuar se mbretet në tërësi pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të parashtruara në mbrojtjen në padi të parashtruar në Dhomën e Posaçme.

Me Urdhër të dt. 06.07.2023, paditësi, është njoftuar më kundër përgjigjjen e të paditurës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Ligji i Dhomës së Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 398 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund t'a jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të pranohet si e bazuar:

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata gjen se paditësi në procedurë të likuidimit të Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel Shpk”, me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit dt.02.02.2015, dhe se me ankuesi me dt.18.03.2015, ka parashtruar kërkesën për kompensim për 8 (tetë) paga të papaguara në shumë të përgjithshme prej 2,345.09 euro, e cila kërkesë është refuzuar me Vendimin e AL-së, PRN173-0281 të dt.25.06.2015 derisa kërkesa / padia e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në sepse këtë vendim paditësi, e ka pranuar pas dt.26.06.2015 kurse kërkesën për shikimin e vendimit - padinë e ushtruar kundër këtij vendimi, pranë Dhomës së Posaçme, e ka bërë përmes dërgimit me postë me dt.03.07.2015, pra brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Vendimi për ushtrimin e saj pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe se kësaj kërkesë, i ka bashkangjitur edhe Vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN173-0281 të dt.25.06.2015.

### ***Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata gjen se nuk është kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, pra paditësit dhe të paditurës, Ndërmarrja Shoqërpë, (NSh), “NewCo Grand Hotel Shpk”, me seli në Prishtinë (në likuidim), ka ekzistuar raporti juridik i marrëdhënies së punës, dhe se nuk është kontestuese se paditësi ka kërkuar që nga NSh-ja, të realizoj kompensim për 8 (tetë) paga të papaguara në shumë të përgjithshme prej 2,345.09 euro, e cila kërkesë është refuzuar si e pavlefshëm me Vendimin e AL-së, PRN173-0281 të dt.25.06.2015

Gjykata gjen se Vendimi i AL-së, PRN173-0281 i dt.25.06.2015, me të cilën është refuzuar kërkesa e palës përmban faktin se AL-ja, kishte vlerësuar kërkesën e paditësit duke refuzuar si

të pabazuar dhe të parashkruar në arsyet si më poshtë konform nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*, dhe nga nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 1999/24, parashikon që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”*, e të cilën qëndrim juridik, gjykata nuk mund ta pranojë si të drejtë.

Gjykata, ka shqyrtuar edhe pretendimet dhe provat tjera të paraqitur nga palët ndërgjyqëse, me të cilat shkresa vërtetohet se paditësi lidhur me objektin kontestues vashdimisht ka kërkuar realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës personalisht por edhe përmes Shoqatës së Sindikatës së punëtorëve duke iu adresuar AKP për kompensimin e tetë pagave të papaguara dhe se AKP me shkresën Nr.246 dt. 07.08.2012, në përgjigje të shkresës së Shoqatës Sindikale

të Pavarur dt. 24.07.2012, ka adresuar shkresën me përmbajtje si në vijim; *“.. kini parasysh se lidhur me pagat e papaguara ekziston procedura ligjore në procesin e likuidimit të Ndërmarrjes së Re ”Hotel Grand Prishtina”*, ku ju do të keni mundësi që të paraqitni kërkesat e juaja kreditore për të gjitha pagat e papaguara dhe se këto kërkesa do të shqyrtohen në mënyrë meritore nga AL-ja në procedurë të përshpejtuar” që konstaton se pretendimet e palës padietse janë paraqitur me kohë tek e paditura, por se kanë ekzistuar rregullat e procedurës për realizimin e të drejtave në procedurë ligjore.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të AKP-së, aty thuhet se: *“Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2”*.

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditëses, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e parapara në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) e në të cilin, parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Për çështjen e pagesës së pagave të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”* kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”* kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se : *“Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes”* ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”*.

Gjykata gjen se paditësi me të drejtë ka parashtruar kërkesën për kompensim në të drejtën e pretenduar, pasi që Autoriteti i Likuidimit ka qenë autoriteti kompetent për shqyrtuar kërkesën

e paditësit në procedurë të likuidimit, por refuzimin e kërkesës nga AL-ja, kjo gjykatë nuk mund ta marrë si të drejtë, pasi dispozitat nga neni 36.2.1 dhe 36.2, të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 të AKP dhe lidhur me parashkrimin sipas dispozitave nga neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ RSFJ 1976), gabimisht janë zbatuar, dhe se në këtë çështje juridike nuk kemi parashkrim të kërkesës së paditësit, dhe se bazuar nga pretendimi i paditësit për kërkesën e parashtruar në shumë prej 2,345.09 €, për periudhën kohore të pretenduar nga muaji dhjetor 2011 – muajin korrik 2012, për të cilët vërtetohet në mënyrë specifike për secilën muaj veç e veç të pretenduar, dhe të pa kontestuar në pikëpamje të lartësisë nga e paditura, në këtë shqyrtim gjykata konsideron si të drejtë pranimin e kërkesës së 8 (tetë) pagave të papaguara e në shumë të përgjithshme prej 2,345.09 € e dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 lidhur me par.1.7 të të njëjtit nen të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në.

Gjykata vendosi që pranoj edhe pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, lidhur me kamatën ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore e në shumën prej 234,50 € e për detyrimin kryesor në të holla në shumën prej 2,345.09 € e duke vepruar në pajtim me dispozitat nga neni 37 par. 3 i Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për AKP ku citon se: *“Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkaloj shumën 10 % të shumës themelore”*.

#### ***Vlerësimet përfundimtare të gjykatës.***

Gjykata pasi që ka administruar prova gjegjëse që gjendjen në shkresat e lëndës, pas konstatimit të gjendjes faktike, ka ardhur në përfundimin se qëndrimi i të paditurës për refuzimin në tërësi si të pa vlefshme të kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën e pretenduar, dhe atë shprehur përmes Vendimit të AL-së, PRN173-0281 i dt.25.06.2015 për NSh “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim) për parashkrimin e kërkesës së paditësit, nuk është i drejtë, dhe se AL-ja, nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, kur është bazuar në nenin 36 par.2 pika 2 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe në nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), andaj nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi, kishte ofruar shërbime punë për NSh-në, se me Njoftimin e dt.02.02.2015, i është përfunduar punësimi, se librezja e tij e punës, i është mbyllur me dt.02.02.2015, se paditësi ka pasur kontrata e lidhur të punës në kohë të pa caktuar, se ka pasur stazhin gjegjës të punës dhe se sipas listave gjegjëse për pagat e pa paguara, NSh-ja, si e paditur, paditësit, i kishte mbetur borxh 8 pagat e pa paguara dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për 8 pagat e pa paguara, në shumën e pranuar të saj. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, I S nga Prishtina e ushtruar kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKPO – Autoritetit të Likuidimit (AL) për kompensimin e 8 (tetë) pagave të pa paguara nga NSh, “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim), është e bazuar dhe se Vendimi, PRN173-0281 i dt.25.06.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL), duhet të ndryshohet si dhe e paditura, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit, duhet të obligohet që paditësit, I S nga Prishtina, në emër të 8 (tetë) pagave të pa paguara t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 2,345.09 € si dhe kamatën ligjore prej 10 % në shumën prej 234.50 €, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor prej 2,345.09 € .

Gjykata ka shqyrtuar edhe qëndrimet tjera të palëve ndërgjyqëse lidhur me kërkesën e parashtruar por të njëjtat nuk janë të bazuara me dispozitat ligjore në fuqi në zbatim, andaj kërkesa është aprovuar si në dispozitiv.

Përfundimisht gjykata ka konstatuar se në rastin konkret pala kundërshtare gabimisht ka vepruar kur ka zbatuar dispozitën ligjore të cituara me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr.06/L- 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale pasi që pala paditëse, edhe pse është gjyqe fituese, i njëjti nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:231054, 23.02.2024**

**Gjykatësi  
Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.